



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke u bazuar në Kërkesën e përfaqësuesve të fshatrave Rubofc dhe Kojskë të datës 28.04.2021 si dhe Shkresës përcjellëse të Drejtoratit për Shërbime Publike të datës 20.05.2021, Kryetari i Komunës merr,

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR EVIDENTIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMTIMEVE
TË RRUGËS**

Neni 1

Përbërja e komisionit

Formohet komisioni për evidentimin dhe vlerësimin e dëmtimeve të rrugës e cila është e dëmtuar si pasojë e punimeve të cilat po kryhen në rregullimin e hekurudhës ku sipas kërkesës –njoftimit të parashtruar nga përfaqësuesit e fshatrave Rubofc dhe Kojskë janë dëmtuar Rruga nga Udhëkryqi i rrugëve Rubofc dhe Gllogovc e emërtuar Rruga “Lipjani” me gjatësi 3500 m, Rr,Murat Zaskoku” me gjatësi prej 1100m , rruga “Nazmi Budakova”me gjatësi prej 220m në fshatin Rubofc dhe Rruga “Avdyl Frashëri” me gjatësi prej 150 m në fshatin Kojskë, në përbërje si vijon:

1. Milaim Qeriqi , Drejtorati për Shërbime Publike , Kryesues
2. Bajram Sinani ,DPUMM, anëtar
3. Behar Mjeku, Drejtorati për Inspektorat, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka detyrë që të bëjë evidentimin, iniqizimin e gjendjes faktike dhe vlerësimin e dëmtimeve të rrugës cila është e dëmtuar si pasojë e punimeve të cilat po kryhen në rregullimin e hekurudhës në rrugët e lartëcekura.

Komisioni detyrat e cekura duhet ti kryej brenda afatit 8 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi dhe të përgadis raport me shkrim me foto të bashkëngjitura për Kryetarin e Komunës

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 343 - 21677
Lipjan, më 25.05.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti